



VENDIM

Nr. 122 Datë 21.11.2011

MBI

**ANKIMIN ADMINISTRATIV TË CEZ SHPËRNDARJE SH.A NË
LIDHJE ME VENDIMIN NR. 99, DATË 30.09.2011 “MBI MIRATIMIN E
STUDIMIT PËR BORXHIN E KEQ”**

Në mbështetje të nenit 9 pikat 1 dhe 4, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 16 dhe 16/1 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të ndryshuara, nenit 25 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 328 të Kodit të Procedurës Civile, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 21.11.2011, mbasi analizoi ankimin e paraqitur nga CEZ Shpërndarje sh.a me shkresat nr. 5462, datë 18.10.2011, 5461/1 datë 24.10.2011, nr. 5462/2 datë 15.10.2011, si dhe relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës,

Konstatoi se:

- Me shkresat nr. 5462, nr. 5462/1, respektivisht të datave 18.10.2011 dhe 24.10.2011, në ERE është depozituar ankimi i CEZ Shpërndarje sh.a, mbi vendimin nr. 99, datë 30.09.2011 “Mbi miratimin e Studimit të Borxhit të Keq”.
- Baza ligjore e paraqitjes se këtij ankimi nga CEZ Shpërndarje sh.a është Kodi i Procedurave Administrative, nenet 115 gërma “a”, 116, 117, 121 dhe neni 16 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s,
- Lënda dhe përmbajtja e këtij ankimi paraqitet me statusin e ankimit administrativ dhe deklarin dhe konstatimin nga ERE të pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr. 99 datë 30.09.2011.
- Ligji nr. 9072 date 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” në nenin 9, të tij përcakton se: *“Kundër vendimeve të ERE-s mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata gjykon vetëm mbi ligjshmërinë ose themelësinë e vendimit të Bordit dhe mund të vendos anullimin pjesërisht ose tërësisht të vendimit, kur nuk e gjen të bazuar në ligj”.*

- Rregullat e Praktikës dhe Procedurave të ERE-s përcaktojnë në nenin 16/1 se: *Çdo person në përputhje me ligjin nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe ligjin nr. 9646 date 30.06.2008. "Për Gazin Natyror" mund të bëjnë ankim ne gjykatë kundër vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare.*
- Neni 25 i Kodit të Procedurave Administrative përcakton detyrimin e organeve administrative për të verifikuar nëse kane ose jo juridiksionin për të vendosur mbi një çështje.
- Me shkresat nr. 5462/1 Prot. datë 20.10.2011 (depozituar ne ERE më datë 24.10.2011) dhe 5462/2 datë 15.11.2011, CEZ Shpërndarje sh.a depozitoi në ERE, Sqarime shtesë në mbështetje të ankimit të CEZ Shpërndarje mbi vendimin e ERE-s nr. 99 datë 30.09.2011 "Për studimin e Borxhit te Keq", duke u shprehur se beson se ky informacion do të shërbeje për rishikimin e vendimit nga ERE.
- Shkresat nr. 5462/1 Prot. datë 20.10.2011 (depozituar ne ERE më datë 24.10.2011), dhe nr. 5462/2 date 15.11.2011, paraqesin një vullnet të ndryshëm nga ai i shkresës nr. 5462, Prot, date 18.10.2011, "Ankimi administrativ mbi vendimin e ERE-s, për miratimin e Studimit te Borxhit te Keq". Në ankimin e datës 18.10.2011, (depozituar ne ERE më datë 20.10.2011), CEZ Shpërndarje ka kërkuar që ERE të deklaroje dhe konstatoje si absolutisht të pavlefshëm vendimin e Bordit te Komisionerëve mbi Borxhin e Keq.
- Konstatimi i pavlefshmërisë se aktit administrativ "Vendimi i Bordit të Komisionerëve nr. 99 datë 30.09.2011", nuk është në juridiksionin e ERE-s, kjo pasi siç cituar më lart në nenin 9 pikat 1 dhe 4, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar, është përcaktuar se: *"Kundër vendimit të Bordit të ERE-së mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata gjykon vetëm mbi ligjshmërinë ose themelësinë e vendimit të Bordit dhe mund të vendosë anulimin pjesërisht ose tërësisht të vendimit, kur nuk e gjen të bazuar në ligj."*
- Rishikimi i vendimit bazuar ne Rregullat e Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, neni 16, ka kusht të procesit për rishikimin e vendimit paraqitjen nga pala e interesuar brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit, të provave të reja që mund të çojnë Bordin të marrë një vendim të ndryshëm nga ai i marrë më parë.
- Në analizë të informacionit shtesë të dërguar më datë 15.11.2011, nuk konstatohet asnjë provë e re nga Bordi i Komisionerëve gjatë shfaqjes së

vullnetit në vendimmarrjen e datës 30.09.2011 “Për Studimin e Borxhit të Keq”.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI :

1. Deklarimin e mungesës së juridiksionit të ERE për kërkesën e CEZ Shpërndarje sh.a për shpalljen absolutisht të pavlefshëm të vendimin nr. 99, datë 30.09.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, “Mbi miratimin e studimit për Borxhin e Keq.”
2. Mos pranimin e kërkesës për rishikim të vendimit sipas shkresës së CEZ Shpërndarje sh.a me nr. 5462/1, datë 20.10.2011, dhe 5462/2 datë 15.11.2011.
3. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 99 datë 30.09.2011.
4. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë CEZ Shpërndarje sh.a për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 122 Datë 21.11.2011

MBI

**ANKIMIN ADMINISTRATIV TË CEZ SHPËRNDARJE SH.A NË
LIDHJE ME VENDIMIN NR. 99, DATË 30.09.2011 “MBI MIRATIMIN E
STUDIMIT PËR BORXHIN E KEQ”**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Sokol Ramadani	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____